



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
Këshilli Drejtues

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më 14/01/2016

V E N D I M

Nr. 2664, datë 14.01. 2016

Për

“Monitorimin e efekteve të mos-diskriminimit të tarifave on-net/off-net dhe pezullimin e fillimit të efekteve të simetrisë së tarifave të terminimit në rrjetet celulare të përcaktuara me Vendim nr. 2542, datë 13.03.2015 për “Disa shtesa dhe ndryshime në Vendimet e Këshillit Drejtues të AKEP me nr. 2522, 2523, 2524, 2525 dhe 2526 datë 06.11.2014””

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Z. Alban	Karapici	Anëtar
3. Znj. Anila	Denaj	Anëtare
4. Znj. Ketrin	Topçiu	Anëtare
5. Znj. Klarina	Allushi	Anëtare

dhe sekretare Znj.Sara Recic, në mbledhjen e datës 14.01.2016, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar dhe Rregullores së Brendshme të AKEP, miratuar me Vendimin Nr. 2506, datë 30.10.2014 të Këshillit Drejtues të AKEP, shqyrtoi çështjen me objekt:

- *Mbi monitorimin e efekteve të mos-diskriminimit të tarifave on-net/off-net dhe ecurinë e skemës për reduktimin e asimetrisë së tarifave të terminimit në nivel shumice në tregun celular*

BAZA LIGJORE

1. Shkronja a), b) dhe ll) të nenit 8, pika 1 dhe 3 e nenit 114 dhe pika 1 e nenit 115 të ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (**ligji nr. 9918**);
2. Kodi i Procedurave Administrative (**KPrA**);

K Ë SHILLI DREJTUES:

Nga shqyrtimi i:

- I. Materialit shkresor si më poshtë:
 1. Relacion shpjegues mbi projektaktin e propozuar për shqyrtim (**Relacioni**);
 2. Projektakti (Vendimi i Këshillit Drejtues) i propozuar për shqyrtim (**Projektakti**);
 3. Dokumentacioni shoqërues:
 - a) Vendim i Këshillit Drejtues të AKEP nr. 2542, datë 13.03.2015 për “Disa shtesa dhe ndryshime në Vendimet e Këshillit Drejtues të AKP me nr. 2522, 2523, 2524, 2525 dhe 2526 datë 06.11.2014”;
 - b) Shkresa e sipërmarrësit Plus Communications sh.a. me Nr.prot.1860, date 2.12.2015 (referenca e AKEP Nr.2143 Prot, date 3.12.2015);
 - c) Shkresa e sipërmarrësit Plus Communications sh.a. me Nr.prot.1909, date 16.12.2015 (referenca e AKEP Nr.2246 Prot, date 18.12.2015).
 - d) Shkresa e sipërmarrësit Vodafone Albania sh.a me referencë LRD/0166/OX, datë 18.12.2015, (referenca e AKEP Nr.2258 Prot, date 21.12.2015);
 - e) Shkresa e sipërmarrësit Albtelecom sh.a me nr.prot.10046, datë 21.12.2015, (referenca e AKEP Nr.2261 Prot, date 22.12.2015)
- II. si dhe nga:
 1. Diskutimet mbi çështjen gjatë mbledhjes së Këshillit Drejtues;
 2. Analiza e fakteve mbi bazën ligjore referuese;
 3. Interesit publik lidhur me çështjen në shqyrtim;

V Ë R E N :

1. AKEP në vijim të shqyrtimit të ankimeve administrative të katër operatorëve celularë për Vendimet nr. 2522-2526, datë 06.11.2014, me Vendimin nr.2542, datë 13.03.2013, vendosi të rishikojë vendimet e ankimuara në lidhje me datat e aplikimit të detyrimit të mosdiskriminimit në tarifën on-net/off-net dhe asimetrinë e tarifës së terminimit në rrjetin Plus. Në pikën 14 të pjesës arsyetuese të Vendimit nr.2542, datë 13.03.2013, AKEP është shprehur si më poshtë:

“AKEP do të monitorojë nga afër zhvillimet në tregun celular, tarifën me pakicë si dhe efektet në trafikun on-net/off-net dhe pagesat neto midis operatorëve, dhe konkurrencën në tregun me pakicë celularë, për të gjykuar mbi nevojën e rishikimit të masave të mësipërme”

2. Plus Communication me shkresën Nr.prot.1860, date 2.12.2015 (referenca e AKEP Nr.2143 Prot, date 3.12.2015), kërkon nga AKEP shtyrjen e zbatimit të tarifës së terminimit 1.48 lek/min në rrjetin e PLUS deri në dhenien e efekteve të qëndrueshme në treg nga zbatimi i plotë i detyrimit të mosdiskriminimit tarifor për të gjithë pajtimtarët me parapagim dhe paspagim, të përcaktuar nga AKEP në Vendimet nr. 2522-2526, datë 06.11.2014, të ndryshuara me Vendimet nr.2542-2546, datë 13.03.2015.
3. Plus kërkon nga KD i AKEP të marre në konsideratë me prioritet maksimal kërkesën urgjente të tij, për rishikimin e masave të Vendimit nr. 2542, datë 13.03.2015, duke shtyrë datën e hyrjes në fuqi të tarifës së terminimit 1.48 lek/min në rrjetin PLUS deri në:
 - datën 01.01.2017, ose
 - marrjen e vendimit të formes së prere në perfundim të procesit gjyqësor,

në mënyrë që së pari të shihen në treg efektet e zbatimit në mënyrë të plote të detyrimit të mosdiskriminimit tarifor e më pas të vijohet me barazimin e tarifës së terminimit në rrjetin PLUS me tarifën e terminimit të operatorëve të medhenj të konsoliduar në treg.

4. Në vijim të shkresës së Plus me Nr.prot.1860, date 2.12.2015 (referenca e AKEP Nr.2143 Prot, date 3.12.2015), dhe takimit të zhvilluar me operatorët celularë, në AKEP janë depozituar dhe shkresat e tjera të mëposhtëme:
 - a. Shkresa e Plus me Nr.prot.1909, datë 16.12.2015 (referenca e AKEP Nr.2246 Prot, datë 18.12.2015), dërguar AKEP dhe institucioneve kryesore në vend.
 - b. Shkresa e Vodafone Albania me referencë LRD/0166/OX, datë 18.12.2015, (referenca e AKEP Nr.2258 Prot, datë 21.12.2015), dërguar AKEP dhe institucioneve kryesore në vend.
 - c. Shkresa e Albtelecom me nr.prot.10046, datë 21.12.2015, (referenca e AKEP Nr.2261 Prot, datë 22.12.2015), dërguar AKEP dhe për dijeni Kryeministrit dhe Ministrit të Inovacionit dhe Administratës Publike.
5. AKEP në vijim të pikës 14 të pikës arsyetuesë të Vendimit nr.2542, datë 13.03.2015, ka monitoruar nga afër implementimin e detyrimit të mos-diskriminimit në tarifën on-net/off-net nga operatorët celularë si dhe efektet në tarifën me pakicë, sasinë dhe strukturën e trafikut të rrjeteve celulare. Nga monitorimi rezulton se të katër operatorët kanë zbatuar në mënyrë të kënaqshme detyrimet e përcaktuara në Vendimet e 13 Mars 2015, dhe kanë qenë bashkëpunues për të eliminuar disa probleme të vogla që janë vërejtur në fillim të implementimit të detyrimit apo në momente të tjera të shkëputura dhe të kufizuara. Nga monitorimi i ndryshimeve në programet tarifore rezulton se operatorët celularë kanë kryer ndryshime të rëndësishme në programet tarifore.
6. Vendimet e AKEP më datë 13.03.2015 kanë përcaktuar që tarifa e terminimit në rrjetin Plus të arrijë nivelin 1.48 lek/minutë më 1.01.2015, pra duke çuar asimetrinë nga 80% në Korrik-Dhjetor 2015 në 0% në Janar 2016. Më 1.01.2016 ka hyrë në fuqi dhe zbatimi i detyrimit të mos-diskriminimit në tarifën on-net/off-net edhe për përdoruesit e tjere me kontratë dhe kjo pritet të sjellë ndryshime të tjera në strukturën e trafikut të operatorëve, për të cilat AKEP gjykon se është e nevojshme që të merret informacion shtesë dhe i vazhdueshëm në muajt në vijim për të vlerësuar efektet e detyrimit të mos-diskriminimit në tarifën on-net/off-net dhe për pjesën tjetër të përdoruesve celularë si dhe simetrisë/asimetrisë së tarifave të terminimit në rrjetet celulare.

PËR KËTË ARSYE:

Këshilli Drejtues, në mbështetje të Pikës 1 të nenit 114, pikës 1 të nenit 115 dhe Rregullores së Brendshme të AKEP,

VENDOSI:

1. AKEP të vazhdojë monitorimin e efekteve të mos-diskriminimit në tarifën on-net/off-net në tregun celular, përfshirë efektet e zbatimit të detyrimit nga data 1.01.2016 për përdoruesit me kontratë (kontrata me programe tarifore standarde dhe të personalizuar/specifike).
2. Të pezullojë fillimin e zbatimit të efekteve të masave rregulluese të vendosura nga AKEP për vlerat e tarifave të terminimit për periudhën 1.01.2016 e në vazhdim të përcaktuar në tabelat

në pikat 2/a dhe 4/a të Vendimit nr.2542, datë 13.03.2015, për “Disa shtesa dhe ndryshime në Vendimet e Këshillit Drejtues të AKP me nr. 2522, 2523, 2524, 2525 dhe 2526 datë 06.11.2014”.

3. Për efekt të llogaritjes dhe faturimit të pagesave të ndërsjellta midis sipërmarrësve lidhur me terminimin e thirrjeve në rrjetet celulare nga data 1.01.2016, sipërmarrësit të përdorin tarifat e përcaktuara nga AKEP për periudhën 1.07.2015 deri 31.12.2015, në Vendimin nr.2542, datë 13.03.2015.
4. Afati i pezullimit i përcaktuar në pikën 2 të këtij Vendimi, është deri në datën e marrjes së vendimit përfundimtar, i cili në çdo rast nuk mund të jetë më i gjatë se 90 ditë pas datës së marrjes së këtij vendimi.
5. Ky vendim të publikohet në faqen web të AKEP www.akep.al brenda ditës së nesërme të marrjes së vendimit.
6. Vendimi hyn në fuqi datën e publikimit të tij ne faqen ëeb të AKEP www.akep.al

K R Y E T A R

Piro XHIXHO

ANËTARËT E KËSHILLIT DREJTUES:

- | | | |
|-------------------|-----------------|----------------|
| 1. Alban | Karapici | Anëtar |
| 2. Anila | Denaj | Anëtare |
| 3. Ketrin | Topçiu | Anëtare |
| 4. Klarina | Allushi | Anëtare |